

NIKO VANGJELI

SHËNIME NGA HISTORIA E PËRKTHIMEVE LETRARE
GJATË RILINDJES

Përkthimi i veprave letrare u bë në fillim të shekullit XX një nga fushat e rëndësishme të jetës kulturele. Shkrimtarë dhe aktivistë të shquar të kulturës shqiptare në veprimtarinë e tyre i dhanë një vend jo të vogël përkthimit të veprave të shquara të letërsisë përparimtare botërore. Ndër ta ishte edhe shkrimtari dhe publicisti patriot Hil Mosi. Në një punim tonin të mëparshëm¹ kemi analizuar përkthimet që bëri Mosi nga vepra e poetit të madh gjerman Gëte. Ky artikull, si vazhdim i atij punimi, shqyrton përkthimet e tjera të Mosit.

Pas Gëtes, ai përktheu edhe nga poetë të tjerë të shquar gjermanë, si H. Hajne, L. Uland, T. Kërner etj. Edhe nga krijimtaria e këtyre shkrimtarëve, Mosi zgjodhi vjersha me tematikë, që u përgjigjeshin nevojave dhe kërkesave të shoqërisë shqiptare, e cila po dilte nga letargjia mesjetare e shek. XIX për të përqaftuar dritën, përparimin, kulturën, për të përvetësuar nocione të reja morale-psikologjike. Poezitë e dashurisë që përktheu Mosi i përgjigjeshin aspiratës së individit për t'u çliruar nga pushteti i përfytyrimeve konservatore dhe për të shijuar të gjitha gëzimet e jetës.

Nga Hajne, Mosi përktheu një tok poezish nga vepra «Buch der Lieder» (1827), të cilat pasqyruan dëshirat dhe shqetësimet rinore të poetit, si «Ich stand in dunkeln Träumen»² (Unë isha në ëndërra të trubullta), «Du bist wie eine Blume»³ (Ti je porsì një lule), «Wenn ich auf dem Lager liege»⁴ (Kur mbi shtrat unë rrija) etj. Motivi qëndror i këtyre krijimeve poetike është ndjenja e sigurtë e dashurisë, hovi rinor, synimi lirik drejt së dashurës.

Në vjershën «Ich stand in dunkeln Träumen» Hajne flet për dashurinë që i ka rrëmbyer zemrën. Në ëndërr, duke këqyrur me mall portretin e vashës, atij i shfaqet fytyra e vashës me buzëqeshjen e saj të ëmbël.

Ich stand in dunkeln Träumen
Und starrte ihr Bildnis an,
Und das geliebte Antlitz
Heimlich zu leben began».

të cilën Mosi e përktheu:

1. N. Vangjeli, *Mbi përkthimin në gjuhën shqipe të disa poezive të J. W. Goethe-s prej Hil Mosit*, «Studime filologjike» 4, 1966, 167-180.

2) *Heines Werke* in fünf Bänden, Volksverlag Weimar 1959 erster Band, f. 70.

3) *Id.*, *Ibid.*, f. 75.

4) Heinrich Heine, *Buch der Lieder*, Volksverlag Weimar 1956, f. 135.

N'nji andërr t'turbullueshme
 M'u duk plot bukuri...
 Sa e pash at ftyrë aq t'kandshme,
 U ndeza prap n'dashtni

Siç shihet, ai u përpoq ta japë idenë, por në disa raste ju largua origjinalit. Hajne thotë qëndroja «stand», në kuptimin rrija në këmbë pa lëvizur, duke shikuar i lektisur portretin. Kjo nuancë ka humbur në përkthim. Mosi gjithashtu e dobësoi hovin e ndjenjës, të cilën e paraqiti më tepër si një soditje pasive.

Më e goditur është strofa e tretë, të cilën Mosi sado që bëri një përkthim të lirë, e dha bukur atmosferën emocionale të origjinalit.

Vargjet e Hajnes:

Auch meine Tränen flossen
 Mir von den Wangen herab —
 Und ach, ich kann es nicht glauben,
 Da ich dich verloren hab.

janë përkthyer:

Dhe mue mbi mollëza t'mija
 M'pikuene lott'e mi;
 E sot çudi më duket
 Si e bana at dashtni?!

Ngazëllimi që i ka ngjallur në zemër e dashura formon edhe bren-dinë e vjershës «Du bist wie eine Blume» (Ti je porsì një lule), të cilën Mosi e përktheu tërësisht, duke i dhënë si titull «Lulja e dashtun»⁵. Stro-fën e parë të kësaj vjershe e dha në shqip me një largim nga origjinali. Dy vargjet e fundit:

Ich schau dich an, und Wehmut
 Schleicht mir ins Herz hinein.

Mosi i shqipëroi:

Një herë un ty me t'kqyrun
 Un ndizem plot dashtni.

duke na paraqitur kështu një situatë pak më të ndryshme. Përkthimi fja-lë për fjalë i këtyre vargjeve do të thotë: unë të shoh dhe malli fshe-hurazi më depërton në zemër, kurse, sipas Mosit, djali ndizet nga ndje-nja e dashurisë, kur e sheh vashën, d.m.th. kur e kujton.

Poezia «Një ftyrë e dukshme»⁶, («Wenn ich auf dem Lager liege») është një nga përkthimet më të goditura të Mosit. Po sjellim si shembull strofën e tretë:

Doch mit dem Traum des Morgens
 Zerrinnt es nimmermehr;
 Dann trag ich es im Herzen
 Den ganzen Tag umher!

5) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, 1927, f. 24.

6) Id., *Ibid.*, f. 82.

të cilën Mosi e shqipëroi, duke na e dhënë qartë idenë e origjinalit:

M'at ftyrë në mjes un çohem,
Me gjan m'e pasë ndër sy:
T'gjith ditën ajo pamje
Në zemër mue m'rri ndry!

Me fjalën «sy», që ka shtuar Mosi, kemi një përforsim realist të kua-drit që na jepet.

Kurse përshkrimi i ndjesive të heroit lirik, dhënë me mjeshtri nga Hajne përmes një metafore të goditur, që shpreh lëvizje (strofa e dytë), në përkthimin e Mosit del e dobët.

Në «Ich wollt meine Schmerzen ergössen»⁷ Hajne flet për mundimet që i sjell malli i zjarrtë që ushqen për vashën. Ai do që këto dhimbje t'i marrë era dhe t'ja çojë asaj, që edhe kur të mbyllë sytë për të fjetur, ato të jenë me të edhe në ëndërrën më të thellë. Mosi dha një përkthim të lirë, që shpreh me imtësira të gjetura mirë gjendjen shpirtërore të të dashurit:

Dhimbët e mija un dishrojshe,
Qi t'u bajshin t'tana një
Edhe erës në dorë t'ja lshojshe,
Qi t'i frynte drejt tek ti.

I goditur është edhe përkthimi i strofës së dytë, të cilën Mosi e shqipëroi duke përdorur fjalë të thjeshta. Ky parim, për ta dhënë përmbajtjen e poezisë me fjalë, pa ngjyrim të veçantë poetik, duket sidomos në përkthimin e strofës së fundit, e cila shquhet për rrjedhshmëri dhe qartësi të mendimit:

Hajne thotë:

Und hast du zum nächtlichen Schlummer
Geschlossen die Augen kaum,
So wird dich mein Wort verfolgen
Bis in den tiefsten Traum.

course Mosi e përktheu:

Dhimbet s'kishin me t'u hiekun,
S'kishin kurr me t'u largue;
Der n'gjum kishin ty me t'ndjekun:
Mallin t'em me ta kujtue!

Në përkthimin e poezisë «Sie haben mich gequalt»⁸ (Ata më kanë munduemun)⁹ Mosi është përpjekur të na japë me saktësi gjendjen shpirtërore të heroit lirik. Duket këtu synimi për ta shprehur brendinë përmes një forme sa më të denjë. Por me një punë më të kujdesshme, përkthimi mund të kishte dalë edhe më i mirë.

7) Hejnrich Heine, Buch der Lieder. Volksverlag Weimar 1956 f. 139.

8) Heines Werke, in fünf Bänden, Volksverlag Weimar 1959 erster Band, f. 49.

9) Hil Mosi, Lule Prandvere, 1927, f. 29

Strofën e parë:

Sie haben mich gequälet,
Geärgert blau und blass,
Die einen mit ihrer Liebe,
Die anderen mit ihrem Hass.

Mosi e përktheu:

Ata më kan munduemun
Kaq sa ma keq nuk ka,
Me anën e zemrës njena,
E tjerët tue mos dashtë me m'pa.

Siç shihet, në disa vise kemi një zbehje të brendisë emocionale të vjershës, sepse Mosi e thjeshtësoi përkthimin, duke hequr fjalët me ngjyrim emocional të theksuar poetik, si Geärgert «i zemëruar», blau, me kuptim këtu «i kapitur, i dërmuar», blass «i zbetë, dyllë i verdhë». Edhe në vargun e katërt, duke shqipëruar «mit ihrem Hass» me shprehjen «tue mos dashtë me m'pa», Mosi e dha mjaft zbehtë idenë e origjinalit.

Më dobët është shqipëruar strofa e dytë. Mosi i shton vargut të tretë fjalën «egër» dhe zhduk në vargun e katërt fjalën Hass «urrejtje», duke u larguar kështu nga origjinali.

Janë përkthyer bukur sidomos dy vargjet e parë të strofës së fundit:

Doch sie, die mich am meisten,
Gequält, geärgert betrübt,

të cilët në shqip tingëllojnë:

Ajo qi mue me t'shumtën
M'mundoj, m'idhnoj, m'turbulloj,

Dy vargjet e fundit të kësaj strofe, ndryshe nga të parat, nuk janë dhënë në një përkthim të goditur.

Përkthimi i vjershave «Es liegt der heisse Sommer»¹⁰ dhe «Vergiftet sind meine Lieder»¹¹ është i mirë; Mosi e ka dhënë saktë idenë e autorit, duke i lejuar ndonjë largim të vogël nga origjinali. Në poezinë e dytë gjejmë mallin e zjarrtë të poetit për të dashurën. Mosi e jep këtë ndjenjë me thjeshtësi dhe natyrshmëri:

T'helmueme jan kangët e mija;
Si ndryshe mund të jetë?
Ti helmin ma pate hedhun
Mu brenda së dashunës jetë

T'helmueme jan kangët e mija
Si ndryshe mund të jetë?
Nde zemër gjarpij plot bari.
Dhe ty o e dash'na e shkretë.

Në ndonjë vend, Mosi i është larguar origjinalit, siç është rasti i vargut të tretë të strofës së parë. Këtu fjala «blühende» (nga blühen lulëzoj) është përdorur si mbiemër për të shprehur diçka në lëvizje dhe në ndryshim të përhershëm, kjo nuk është në përkthim, sepse Mosi e

10) Heines Werke in fünf Bänden, Volksverlag Weimar 1959 erster Band, f. 49.

11) Heinrich Heine, Buch de Lieder, Volksverlag Weimar 1956, f. 98.

ka dhënë në shqipe me fjalën «e dashun» (jetë), shka ka sjellë humbjen e nuancës emocionale-psikologjike.

Mosi u përpoq të japë një përkthim të saktë edhe të vjershës «Ich hab im Traum geweint»¹² (Me lot në gjum kam qamun)¹³. Strofa e parë është shqipëruar me besnikëri dhe rrjedhshëm. Kurse në strofën e dytë nuk del ideja e origjinalit. Brenda e kësaj strofe është frika se mos e dashura e braktis përgjithmonë.

Ich hab im Traum geweint
Mir träumt, du verliessest mich
Ich Wachte auf, und ich weinte
Noch lange bitterlich,

Mosi i përktheu kështu:

Me lot në gjum kam qamun
M'u duk se ti m'ishe nda.
Dhe mbrapa mbas qi u zgjova
Un ndejta prap tue qa.

Folja «Verlassen» mund të jepej shqip me ekuivalentin e vet «braktis», shka do të lejonte të jepej me përpikmëri gjendja shpirtërore e heroit lirik. Efekti i vargut të fundit është dobësuar edhe nga lënja jashtë në përkthim të fjalës «bitterlich» (i hidhur, i dhimbshur).

Vargu i tretë dhe i katërt të strofës së fundit janë përkthyer bukur, por pa forcën e origjinalit:

Ich wachte auf, und noch immer
Strömt meine Tränenflut.

thotë Hajne, kurse Mosi i dha:

Dhe mbrapa mbas qi u zgjova
Lot't m'rridhshin krejt si shi.

«Tränenflut» përbëhet prej dy emrash: «Tränen» (lotë) dhe «Flut» (baticë, rrymë e fuqishme uji, tallaz). E dhënë kjo fjalë në shqipe me «shi», vargu ka humbur ngjyrimin e vet poetik — emocional.

Një nga përkthimet më popullore të Mosit është kënga e L. Ulandit «Der Gute Kamerad»¹⁴ (Shoku besnik), e cila u këndua në vitet '20 si këngë patriotike nga nxënësit e shkollave. Në vepër lartësohet solidariteti dhe shoqëria e ngushtë midis shokëve, që shkojnë në luftë kundër armiqve të atdheut, të lidhur me fijet e miqësisë së ngushtë për njëri-tjetrin. Kjo ide i shkonte atmosferës së entuziazmit patriotik, prandaj edhe Mosi e përktheu. Shqipërimi është bërë me kujdes dhe dashuri. Mosi kishte marrë pjesë vetë me armë në dorë për lirinë e Shqipërisë, prandaj idenë e këngës e kishte shumë për zemër.

«Der Gute Kamerad» (shok i mirë) Mosi e dha në shqipe me «Shoku besnik», që e shpreh bukur idenë e këngës:

12) *Heines Werke* in fünf Bänden, Volksverlag Weimar 1959 erster Band f. 52.

13) Hil Mosi, *Lule Prandvere*, 1927 f. 110.

14) *Uhlands Gedichte und Dramen* zweiter Teil Stuttgart. Verlag der J.G. Gotta'schen Buchhandlung 1880 f. 66

Dy vargjet e para:

Ich hatt'einen Kameraden,
Einen bessern findst du nit

Mosi i përktheu:

Nji shok besnik un kishe,
Si atë nuk gjej as kah.

Duke shtuar fjalët «besnik» dhe «as kah» Mosi e përforcoi edhe më idenë e rëndësisë dhe të vlerës së shoqërisë së singërtë.

Tre vargjet e fundit të strofës së parë:

Die Trommel schlug zum Streite,
Er gieng an meiner Seite
In gleichem Schritt und Tritt.»

Mosi i dha me katër vargje:

Për sulm burija bijte
Aj pranë meje rrijte
E ec-shim krah për krah
E ec-shim krah për krah.

Përsëritja e vargut të fundit i jep vjershës një ton vendosmërie. Siç duket, këtë gjë përkthyesi e bën për hir të kompozimit. Në vargun e parë fjalët «Die Trommel» dhe «Streite» nuk janë përkthyer saktë: fjala e parë do të thotë «daulle, trompetë», kurse e dyta «luftë»; me gjithë këto ndryshime, ideja e këngës është ruajtur.

Bukur është shqipëruar edhe strofa e dytë, sidomos tre vargjet e saj të fundit:

Në trup plumbi përshkohet
Të shokut qi rrezohet
M'u duk se ishe vetë
M'u duk se ishe vetë.

Mosi e ka dhënë ndarjen e shokut si një veprim që zgjat, për të theksuar më tepër dhimbjen e humbjes. Përkthim i goditur është edhe ai i vargut «Als wärs ein Stück von mir» (sikur t'ish një copë prej meje), që në shqipet është dhënë me frazën «M'u duk se ishe vetë», e cila e jep në mënyrë shumë shprehëse dashurinë dhe hidhërimin për shokun e afërt.

Strofën e fundit Mosi e përktheu, duke e dhënë me shprehimësi dhimbjen për ndarjen e shokut. Ai e ka arritur ta theksojë më tej dramatismin, duke futur disa fjalë që nuk i ka origjinali.

Will mir die Hand noch reichen,
Derweil ich eben lad':
Kann dir die Hand nicht geben;
Bleib du im ewgen Leben
Mein guter Kamerad!»

Mosi e përktheu:

Aj dorën don t'ma api
Kur se un shti m'anmik.
Ah dora nuk më mbahet,
Ah shoku po më dahet:
Lam't'mirë, ti shok besnik
Lam't'mirë ti shok besnik!

Dramatizmin e situatës ai ka arritur ta japë duke e zëvendësuar gjermanishten lad «mbush» (pushkën) *me shtie* dhe duke shtuar fjalën *armik*, e cila nuk është në origjinal. Një ndryshim i tillë e ka bërë më të fortë kuadrin që na jep vjersha. Në tri vargjet e fundit të përkthimit ideja është shkrirë në mënyrë të barabartë. Vargu i tretë «Kann dir die Hand nicht geben», që fjalë për fjalë do të thotë «Nuk mund të të jap dorën», nuk është shqipëruar saktë. Duke e dhënë vargun e origjinalit me shprehjen e papërcaktuar «Ah dora nuk më mbahet», Mosi nuk arriti ta shprehë qartë idenë e Ulandit.

Mosi na ka lënë edhe dy përkthime të kujdesshme nga Ulandi «Schicksal»¹⁵ (Fati)¹⁶ dhe «Seliger Tod»¹⁷ (Vdekje e lumtun).

Poet tjetër, që tërhoqi vëmendjen e Mosit, qe Kërner, poet patriot, i cili ra në luftë për lirinë e atdheut të vet; nga Kërneri ai përktheu tri poezi: «Liebesrausch»¹⁸ (Të dejun dashnie)¹⁹, «Die Augen der Geliebten»²⁰ (Syt e dashnores)²¹ dhe «Die Eichen» (Lisat).²²

Për vjershën «Liebesrausch» është karakteristik sinqeriteti i ndjenjës, thjeshtësia dhe forca emocionale. Këtë poezi Mosi e përktheu me kujdes. Ai na jep entuziasmin e djaloshit, i cili rron me mallin e së dashurës:

Dir Mädchen, schlägt mit leisem Beben
Mein Herz voll Treu' und Liebe zu.
In dir, in dir versinkt mein Streben,
Mein Schönstes Ziel bist du!

të cilat Mosi i përktheu:

Për ty, o vashë kjo zemra ime
Me besë dashnore rreh gjithnji
Veç ty gjithmon të kam n'kujtime,
Se shpresa e jeme je gjith ti!

Siç shihet, dy vargjet e fundit të strofës janë dhënë me përkthim të lirë. Kërneri thotë (po ta përkthejmë fjalë për fjalë): në ty, në ty zhduken (humbasin, futen, bien) përpjekjet e mia, qëllimi im i lartë je ti! Mosi, duke thënë: «... shpresa e jeme je gjith ti» e zbehu idenë: dashuria e vashës për djaloshin është më tepër se një shpresë, ajo përbën kuptimin e jetës së tij.

Edhe strofën e dytë Mosi e dha në përkthim të lirë. Këtu ai la jashtë emrat abstraktë, «e mira» dhe «e bukura» (në shkëlqimin e së mirës dhe të së bukurës), duke e dhënë kuptimin e tyre me fjalën «hyri»: «E para mejet si hyrija e ytja ftyrë asht kah ndritson».

Në përkthimin e strofës së tretë Mosi synoi ta përforcojë frymën emocionale të vjershës. Kështu foljen jeton «lebst», e dha në shqipe me «mbretëron», dhe shtoi fjalët «... si shoqe s'ka». Kështu vargjet:

15) Id., Ibid., f. 146

16) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, shtypur në shtypshkronjën «Mbrothësija» Kristo Luarasi, Tiranë, f. 44

17) *Uhlands Gedichte und Dramen zweiter Teil* Stuttgart. Verlag der J.G. Gotta'schen Buchhandlung 1880, f. 30.

18) *Theodor Körners sämtliche Werke* Stuttgart und Leipzig Deutsche Verlags — Anstalt, f. 39

19) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, 1927, f. 84.

20) *Theodor Körners sämtliche Werke* Stuttgart und Leipzig Deutsche Verlags — Anstalt, f. 82.

21) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, 1927, f. 89.

22) Botuar në gazetën «Lidhja Orthodhokse», 10 korrik 1909.

Die Liebe sprosst aus zarten Keimen,
Und ihre Blüten welken nie!
Du Mädchen, lebst in meinen Träumen
Mit Süsßer Harmoni.»

Mosi i përktheu:

Prej buleve t'njoma del dashtnija,
Të sajat lule s'dijnë m'u tha!
Ti, vashë, mbretnon ndër andrra t'mija
M'nji ambëlsi qi shoqe s'ka

Strofën e tretë Mosi e përktheu duke u larguar nga origjinali. Me lënjen mënjandë të foljes «glüht» që do të thotë shkëlqen, është zbehur ideja e patosit rinor. Vargun e tretë, që fjalë për fjalë do të thotë: «Ah! të gjitha huret që ty të zbukurojnë», Mosi e dha në shqipe kështu: «Me gjylypet tua krejt si dielli». Krahasimi «si dielli» nuk shkon; vërtet dielli është burim i jetës, i çdo qenjeje të gjallë, por këtu nuk ndihmon për zbulimin e idesë.

Poezinë «Die Augen der Geliebten» Mosi e shqipëroi të lirë. Motivi qendror i vjershës së Kërnerit është dashuria e të riut për t'u bashkuar për jetë me të dashurën. Vise-vise Mosi ka bërë punë të mirë, por në përgjithësi përkthimi lë mjaft për të dëshiruar. Si punë të mirë mund të cilësohen katër vargjet e strofës së parë:

Augen, zarte Seelenblüten,
Klare Perlen ew'ger Liebe.
Augen, ihr verehrte Augen.
Meiner Herrin lichte Sterne.

të cilat Mosi i dha me këto fjalë:

Sy t'dashtun, lule t'shpirtit
O inxhi t'dashtnis s'përvjetshme!
Sy o sy, aq fort t'nderueshëm
Ju, o hyj t'dashtnores s'eme.

Strofa e fundit nuk e jep atmosferën emocionale të origjinalit. Po ta përkthejmë fjalë për fjalë këtë strofë na del: Dhe kështu dëgjoni përsëritjet e këngëtarit / a nuk do të donit ju miqësisht djaloshit, si dioskuret e përvjetshme / ti ndriçoni nëpërmjet valëve të jetës? / Sy, lulëzime të hijshme të shpirtit, a do të donit ju t'ishit yjet e mi? Kurse Mosi e përktheu me këto vargje të zbeta:

Ju o sy a s'ja ndëgjoni
njiket t'lutun kti dashtnorit?!

Ju t'gjith jetën mue t'më ndritni
Sy dy hyj aq fort t'shkëlqyeshëm.
Tue më pru gjallim në shpirt!

Mosi përktheu edhe nga krijimtaria poetike e Shilerit. «Hektors Abschied»²³ (Lamtumir' i Hektorit)²⁴ dhe «An den Frühling»²⁵ (Prandverës)²⁶ janë nga shqipërimet e këtij poeti, te të cilat duket se është punuar me kujdes.

23) Friedrich Schiller, *Gesammelte Werke* Zweiter Band Aufbau — Verlag Berlin 1954 f. 45.

24) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, 1927, f. 111.

25) Friedrich Schiller, *Gesammelte Werke* Erster Band Aufbau-Verlag, Berlin 1954, f. 97.

26) Hil Mosi, *Lule Prendvere*, 1927, f. 22.

«Hektors Abschied» Shileri e shkroi aty nga viti 1776, por e ripunoi disa herë. Në fillim ai u hartua si këngë që ekzekutoi Amalia, heroína e dramës «Cubat», kur plaku Moor i drejtohet para vdekjes duke i thënë: «Një këngë të bukur, bija ime, Ti duhet të ma këndosh para se unë të vdes». Por «Hektors Abschied» bëri jetën e saj të pavarur si baladë. Si të tillë e përktheu edhe Mosi të plotë më 1915. Përkthimi në shqipe është i lirë, por shquhet nga rrjedhshmëria dhe natyrshmëria.

Teueres Weib, gebiete deinen Tränen!
Nach der Feldschlacht ist mein feurig Sehnen,
Diese Arme schützen Pergamus.

thotë Shileri, ndërsa Mosi e përktheu kështu:

Grue e dashun lene sot vajtimin,
Se un atje në luftë e kam mendimin,
Njikto duer Pergamon do ta mbrojnë!

Në përgjithësi mirë janë përkthyer fjalët e fundit të Hektorit drejtuar Andromakës, në çastin kur armiku po u afrohej mureve të kështjellës.

Vargjet e Shilerit:

T'gjith ç'a mall në zemër un kam mbjellun
N'lum të Lethes due un sot m'e hjedhun...
Mue dashtnija kurr nuk m'vdes!
Ndij! i luftës tek ndihen hé kushtrimet!
Ngjeshma shpatën, grue, e len vajtimet,
Se dashtnija e jeme kurr nuk vdes!

Në poezinë «An den Frühling (Prandverës) Shileri i ri, duke i kënduar stinë më të bukur të motit, pranverës, shprehu mallin e zjarrtë që i zjen në zemër. Kjo ka dalë qartë në strofën e tretë ku djaloshi i drejtohet pranverës me fjalët:

Denkst auch noch an mein Mädchen?
Ei, Lieber, denke doch!
Dort liebte mich das Mädchen,
Und's Mädchen liebt mich noch!

të cilat Mosi i dha me vargjet:

A thue prap vashën time
Ti je kah e kujton?
Atje vasha më deshti
E prap dhe sot më don.

Në përgjithësi, siç shihet më sipër, Mosi dha një përkthim të lirë, i cili herë-herë largohet mjaft nga origjinali. Por ka vargje të rrjedhshme dhe të goditura. E tillë është strofa e dytë, e cila është e mveshur me një shqipe të bukur:

Ei! ei! da bist ja wieder!
Und bist so lieb und schön!
Und freuen wir uns so herzlich,
Entgegen dir zu gehn.

të cilën Mosi e dha kështu:

Ah! prap ti ne na dole,
E bukur plot dashni!...
E, ne qi ty të pritme,
Na mbushe plot knaqsi.

* * *

Duke përfunduar, mund të themi se Mosi bëri përpjekje për të na dhënë shqipërime të goditura nga Hajne, Ulandi, Kërner dhe Shiler. Në përgjithësi ai e paraqiti atmosferën emocionale-poetike që shquan veprat që përktheu si vrullin e mallit rinor dhe pastërtinë e ndjenjës së dashurisë. Doemos, në disa raste varfëria e mjeteve poetike të përdorura prej tij nuk lejoi të dalë në mënyrë sa më shprehëse lirizmi dhe fryma poetike që karakterizojnë vjershat që zgjodhi Mosi për përkthim. Por m'anë tjetër duhet theksuar, se, duke pasur parasysh lexuesin shqiptar të kohës, Mosi përdori një fjalor poetik sa më konkret dhe më të kuptueshëm; në përkthimet e tij rrallë takohen fjalë të huaja. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, përkthimet e Mosit duhen shikuar si një punë pozitive nga pikëpamja kulturele e shoqërore.

R é s u m é

NOTES SUR L'HISTOIRE DES TRADUCTIONS LITTÉRAIRES A L'EPOQUE DE LA RENAISSANCE ALBANAISE

La traduction des oeuvres littéraires était devenue, au commencement du XX^e siècle, un des domaines importants de la vie culturelle de l'Albanie. Des hommes de lettres et des activistes de la culture albanaise ont donné une place non petite à la traduction des meilleures oeuvres de la littérature progressiste mondiale. De leur nombre était aussi l'homme de lettres et le publiciste patriote, Hilë Mosi.

L'auteur, dans un travail antérieur, a analysé les traductions faites par Mosi de l'oeuvre du grand poète allemand Wolfgang Goethe. Cet article, qui représente la suite du premier, examine les autres traductions de Mosi.

Outre quelques poésies de Goethe, Mosi a traduit aussi d'autres poète allemands éminents, comme H. Heine, L. Uhland, Th. Körner, F. Schiller, etc. L'auteur analyse les poésies traduites par Mosi, en considérant dans quelle mesure ont été conservées dans ces traductions les opinions des auteurs, s'il est réussi à mieux correspondre par la phrase à l'original et à la valeur artistique de l'énonciation. Il considère généralement réussi le travail du traducteur, ce qui a concouru à faire connaître les auteurs étrangers en Albanie.

Mosi brosse, en général, parfaitement l'atmosphère émotivo-poétique qui empreint les oeuvres traduites, ainsi que l'entrain de jeunesse et la pureté du sentiment de l'amour. Il va sans dire que, dans quelques cas, la pauvreté des moyens poétiques utilisés par le traducteur n'a pas permis une réussite plus expressive au lyrisme et à l'esprit poétique qui caractérisait les poésies traduites. Mais, il faut faire remarquer d'autre part qu'en tenant présent le lecteur albanaise du temps, il a employé un vocabulaire poétique le plus concret que possible, le plus compréhensible. Dans ses traductions, on ne rencontre que rarement des emprunts étrangers.

Indépendamment de ces dernières remarques, les traductions de Mosi doivent être considérées comme un travail positif au point de vue culturel et social.